



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 181, Datë 13.07.2022

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “NRG POWER” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1118/1 prot., datë 12.07.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 130, datë 31.05.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 70/23 prot., datë 31.05.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 14.06.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 673/1 prot., datë 06.06.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin dhe informacionin plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 673/2 prot., datë 10.06.2022, dhe nr. 673/4 prot., datë 27.06.2022.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për

dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “e”.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjykatës për administratorin e saj brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjykatës për administratorin e saj.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI